



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.6 të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, nxjerrë këtë:

## **Udhëzim Administrativ Nr. 2/2015 Për Kontratat publike kornizë**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativë është që të japë sqarime për Autoritetet Kontraktuese në lidhje me zbatimin e nenit 38 (Kontratat Publike Kornizë) të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04 / L-042 dhe nenit 50 (Kontratat Kornizë) të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë.

### **Neni 2 Termet e përdorura**

Termet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Definicionet) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

### **Neni 3 Përmbajtja e Kontratës Publike Kornizë**

Përmbajtja e Kontratave Publike Kornizë është e përcaktuar në nenin 38 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 04 / L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 50 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë

### **Neni 4 Kohëzgjatja e Kontratës Publike Kornizë**

- 4.1 Në përputhje me nenin 38, paragrafin 2 të LPP, asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.
- 4.2 Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se 36 muaj, ajo nuk mund të zgjatet deri në një maksimum prej 36 muaj. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit.

### **Neni 5 Vlera dhe sasia e kontratës publike kornizë**

- 5.1 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si *një prag* apo *një tavan* dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes se lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus / minus 30%.
- 5.2 Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

#### **Neni 6**

#### **Kontrata publike kornizë me më shumë se një operator ekonomik, faza e mini-tenderimit**


- 6.1 Kur një kontratë publike kornizë shpërblehet tek më shumë se një Operator Ekonomik, do të kërkohet nga të gjithë Operatorët Ekonomik të shpërblyer që të dorëzojnë mini-tenderë dhe të gjithë Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertat.
- 6.2 Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomik që janë palë të Kontratës Publike kornizë dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme. Autoritetet Kontraktuese do të shpërblejnë kontratën operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterit të dhënies të përcaktuara në ftesën për ofertim.
- 6.3 Edhe në rast se Autoriteti Kontraktues pranon vetëm një ose dy tenderë dhe pjesa e mbetur e operatorëve ekonomik nuk dorëzojnë tender për mini-tenderin e veçantë, Autoriteti Kontraktues mund të vazhdoj me tenderuesin(it) i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterit të dhënies të përcaktuar në ftesën për ofertim.

#### **Neni 7**

#### **Hyrja në fuqi**

- 7.1 Ky Udhëzim Administrativ, hynë në fuqi më: 10.03.2015

05/03/2015  
(data e nënshkrimit)

  
Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së